Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

Vula

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti përgjegjës), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 9

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

### DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 42 të Aktit normativ nr.9/2019.

- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019<sup>2</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin Përgjegjës të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 11

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

### DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE<sup>3</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet të deklarojnë se nuk kanë pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndertimet civile civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

**Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

<sup>3</sup> Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përvallimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 42, pika 5 shkronja ë).



**Shtojca 12**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> <b>Punë:</b> Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
...	_____	_____

## Shtojca 13

[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.**

**Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, seicili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.**

**Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Ligji nr.162/2020 “Per prokurimin Publik” neni 14

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
  - b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*
  - c. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;*
  - ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
  - d. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*
  - dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;*
  - e. *Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.*
- ë. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës),*

### **2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, pranimit/kualifikimit (Shtojca 13)

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

- 2.2.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020) të paraqitur në Autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) të konfirmuara nga ky autoritet.
- 2.2.2.** Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilave duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kësaj procedure.
- 2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e Taksave Vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo Operator, anëtar i bashkimit, duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB)*

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

#### **2.3.1. Përvojë e mëparshme**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, me vlerë jo më të vogël se 30% e fondit limit të kësaj procedure.

A. Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar, formularin / vërtetimin e vlerësimit për realizimin e shërbimit dhe/ose faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe shërbimi i realizuar.

B. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Autoriteti përgjegjës mund të përcaktojë kritere kualifikimi sipas natyrës dhe objektit të prokurimit duke pasur respektuar kuadrin regullator të rindërtimit dhe LPP.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**2.3.2. Liçenca Profesionale e Shoqërisë**, për realizimin e punimeve, objekt i kontrates, të lëshuar nga autoritetet përkatëse Shtetërore, në kategoritë:

***PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI***

NP - 1

NP - 2

NP - 3

NP - 12

***PUNIME SPECIALE NDËRTIMI***

NS - 1

NS - 2

NS - 3

NS - 4

NS - 8

NS - 9

NS - 12

NS - 13

NS - 14

NS - 18

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

**2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik në Liçencën e shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:**

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

- Arkitekt 1 (një)

### **Për të cilët duhet të paraqiten:**

- Liçencë profesionale individuale në mbikqyrje dhe kolaudim punime zbatimi.
- Diplomë, CV
- Kontratë pune (e vlefshme)
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator 2020 – Shkurt 2021. Për këtë duhet të dorëzohen Listpagesat sipas formatit E-Sig 025/a.

### **2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit e tij inxhinierët si më poshtë:**

- |                         |         |
|-------------------------|---------|
| - Inxhinier ndërtimi    | 1 (një) |
| - Inxhinier Topograf    | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| - Inxhinier Mekanik     | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektrik    | 1 (një) |
| - Inxhinier Mjedisi     | 1 (një) |

### **Për të cilët duhet të paraqiten:**

- Diplomë, CV
- Kontratë pune e noterizuar
- Liçencë profesionale individuale në mbikqyrje dhe kolaudim punime zbatimi.
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Shtator 2020 – Shkurt 2021. Për këtë duhet të dorëzohen listpagesat sipas formatit E-Sig 025/a.

**2.3.5.** Për efekt të kryerjes së shërbimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjës të siguar. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Shtator 2020 – Shkurt 2021.

**2.3.6.** Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve sipas standarteve të mëposhtëme:

- **ISO 9001:2015** ose ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.
- **ISO 14001:2015** ose ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.
- **ISO 18001-2007** ose ekuivalent të vlefshme për sistem menaxhial të shëndetit dhe sigurisë në punë.

*Në rastet e Bashkimit të operatorëve ekonomikë kushti i mësipërm duhet të plotësohet të paktën nga njëri anëtar i bashkimit.*

Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim,

mbikqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, nr. 5585 prot., “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016” “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim*”.

*Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## Shtojca 14


*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës]*

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:



Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Sipas procedurës së punës të publikuar me të dhenat si me poshte:**

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **“Punime perforcimi, reabilitimi dhe rikonstruksion i godines ne rrugen Jordan Misja, Tirane”**

Numri i Referencës: **REF-93872-04-23-2021**

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## **Shtojca 15**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës ]*

### **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: **Mbikeqyrja e punimeve për "Godinen në rrugën Jordan Misja, në kuadër të procesit të rindertimit"**

Afatet e ekzekutimit: **Afati i realizimit të mbikqyrjes do të jetë 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

**Marrëveshja kuadër: 12 muaj.**



## Shtojca 16

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës)

### **TERMAT E REFERENCËS**

MBIKQYRJE PUNIMESH PER OBJEKTIN :

**Mbikeqyrja e punimeve per "Godinen ne rrugen Jordan Misja, ne kuader te procesit te rindertimit"**

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Godina ne rrugen Jordan Misja, Tirane, ne kuader te procesit te rindertimit”**

Detyrat:

**Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:**

*Ne baze te Udhëzim Nr.3, datë 15.2.2001, “PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, Ndryshuar me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 17.5.2001, Ndryshuar me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.7, datë 21.11.2001, Ndryshuar me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 22.2.2005,*

Mbikeqyrja e punimeve bëhet për cdo objekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij.

Mbikeqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me certifikatë profesionale përkatëse. Mbikëqyrësi i punimeve për objekte që ndërtohen me financim publik, emërohet nga investitori pas përzgjedhjes me prokurim në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

1. Sipërmarrësi duhet të njoftojë, me shkrim, përpara fillimit të punimeve, në seksionin e urbanistikës pranë organeve të qeverisjes vendore, Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik në nivel komune/bashkie/qarku, drejtoritë rajonale tatimore dhe INUK-në, sipas rasteve të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse.  
Në këtë njoftim të shënohet emërtimi i objektit, të dhënat e investitorit, projektuesit, zbatuesit dhe mbikëqyrësit të punimeve.
2. Seksioni i urbanistikës dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar/Vendor kontrollojnë praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij, nxjerrin vendim për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt.

3. Personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit janë:
  - a. investitori;
  - b. sipërmarrësi;
  - c. mbikëqyrësi i punimeve.
4. Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:
  - i. lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë;
  - ii. aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - iii. Projektin e zbatimit të firmosur nga projektuesi dhe të konfirmuar nga komuna/bashkia/këshilli i qarkut, sipas juridiksionit.

Projekti i zbatimit përmban:

1. projektin e plotë arkitektonik, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
2. projektin e plotë konstruktiv, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
3. projektin e plotë elektrik, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
4. projektin e plotë hidrosanitar, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
5. projektin e plotë ngrohje-ftohje-ventilim, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
6. projektin e plotë të mbrojtjes nga zjarri, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
7. projektin e plotë të sistemimeve të jashtme së bashku me relacionin teknik shpjegues;
8. projektin e plotë të lidhjes së objektit me rrjetet inxhinierike, së bashku me relacionin teknik shpjegues;
9. Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit
10. Studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;
11. Studimin sizmik
12. Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit;
13. Lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore, të miratuar nga organi kompetent;
14. Ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre;
15. Certifikatat profesionale (licencat), të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit (shoqërisë sipërmarrëse dhe mbikëqyrësit)
16. Njoftimin për fillimin e punimeve (formati tip)
17. Procesverbalin për fillimin e punimeve në objekt (formati tip)
18. Aktin e piketimit të objektit (formati tip)
19. Aktkontrollin e kuotës  $\pm 0.00$  (formati tip)
20. Librezën e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e tyre (formati tip);

21. Situacionet mujore pjesore dhe progresive, hartuar në përputhje me (formati tip);
22. Librin e kantierit;
23. Ditarin e objektit (formati tip)
24. Pasqyrën e realizimit të punimeve (formati tip)
25. Procesverbalet e punimeve të maskuara (formati tip);
26. Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton etj.
27. Aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit (në përfundim të kësaj faze);
28. Deklaratën teknike të sipërmarrësit (formati tip);
29. Aktin e kolaudimit të fazës së karabinasë;

Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse;

- a. Aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve (formati tip);
  - b. Dokumentin e vlerësimit të rrezikut, që hartohet për një kantier të veçantë, sipas vendimit nr. 312, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", i quajtur Plani i Sigurisë dhe Koordinimit (PSK);
  - c. Siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt;
  - d. Siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta.
5. Sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi përgjigjen për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të mbajtur në objekt.
  6. Dokumentacioni i objektit ruhet me çdo kusht.
  7. Në castin e fillimit të punimeve, mbikëqyrësi duhet të bëjë verifikimet paraprake, si më poshtë vijojnë:
    - i. Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licensave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat, sipas dispozitave në fuqi, duhet të merren para fillimit të punimeve.
    - ii. Verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
    - iii. Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe e të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
  8. Investitori, drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.
  9. Vendosjen e tabelës së identifikimit me të dhënat e mëposhtme:

- a. Emërtimi i objektit;
- b. Data e marrjes së lejes së ndërtimit;
- c. Investitori;
- d. Projektuesi;
- e. Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
- f. Mbikëqyrësi;
- g. Afati i ndërtimit;
- h. Sipërfaqja e ndërtimit;
- i. Lartësia (numri i kateve mbi dhe nëntokë);
- j. Intensiteti sizmik i sheshit të ndërtimit, në bazë të studimit sizmiologjik dhe mikrozonimit sizmik.

10. Mbikëqyrësi i punimeve, pas verifikimeve të përcaktuara në pikën 7, harton dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit shoqërisë sipërmarrëse.
- ii. Aktin e dorëzimit nga sipërmarrësi të dokumentacionit, teknik dhe administrative si licenca, autorizime e leje të marra nga sipërmarrësi.
- iii. Shkresën me anë të së cilës njofton pushtetin vendor për fillimin e punimeve.

11. Mbikëqyrësi i punimeve, gjatë zbatimit të objektit, i jep instruksione dhe urdhra, me shkrim, sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme, në zbatim të akteve, ligjore e nënligjore dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke ruajtur të drejtën t'i bëjë me shkrim investitorit vërejtjet e tij, për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

12. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të propozojë largimin nga puna të një ose të disa personave nga personeli i sipërmarrësit. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim titullarit të shoqërisë sipërmarrëse, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

13. Materialet që vijnë në kantier duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit. Materialet në vepër përdoren vetëm me miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipërmarrësi, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e sipërmarrësit. Në këto raste (si për materialet, ashtu dhe për pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

14. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara

dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.

15. Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit, në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
16. Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në cdo rast me miratimin e investitorit për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.
17. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton cdo muaj investitorëve për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t'u ekzaminuar prej tij.
18. E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin, përbën dokumentacionin e objektit dhe, si e tillë, ruhet me cdo kusht.
19. Dosja e mbikëqyrjes së punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit. Mbikëqyrësi i punimeve nuk ndërrohet, me përjashtim të rasteve të detyruara.
20. Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat të lindura gjatë punës, ndërprejet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.
21. Mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga investitori për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi, në përputhje me kontratën e nënshkruar. Mbikëqyrësi, përveç shërbimeve të kontrollit për zbatimin e punimeve, ndjek edhe grafikun e punimeve.
22. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:
  - a. Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
  - b. Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
  - c. Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

23. Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.
24. Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.
25. Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithshka që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.
26. Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.
27. Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të punëdhënësit, bashkë me vërtetimin e përkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim.
28. Punimet e përforcimit vecanërisht, duhet të dokumentohen edhe me fotografi sa më të detajuara.
29. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit, si dhe i jepet për likuidim investitorit.
30. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar, dhe i raporton, periodikisht, investitorit për gjendjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.
31. Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, investitori ose dikasteri nga varet ky investitor, si dhe degët e policisë së ndërtimit, kanë të drejtë të urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës, deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes.

32. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

*Shënim : Në bazë të volumit të punimeve dhe vleftës së kontratës mbikqyresi i punimeve duhet të jetë prezent në objekt gjate kohes qe ne objekt ka punime, (aktivitet ndertimor)dhe stafi tjetër mbikëqyrës duhet të jetë prezent çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesshme ne funksion te specifikave te punes.*

### **KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES**

Do të jetë për gjithë periudhen e zbatimit të punimeve (12 muaj)

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Godina ne rrugen Jordan Misja, Tirane

## Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

### **NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë keni të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore



< Emri >

## Shtojca 18

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Etj.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NUIS-it*

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_ numri i NUIS-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_ numri i NUIS-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_ numri i NUIS-it

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me \_\_\_\_\_ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

## Shtojca 19

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit përgjegjës]**

## Shtojca 20

### KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet

#### Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3 Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikak Korrutive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korrutive. Veprimet korrutive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 18 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
